



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 14 paragrafi 2 dhe Nenit 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03 / L-85,
2. Dispozitat e Nenit 11 në Licencën për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Ngrohjes.
3. Kërkesën për miratimin e draftit “Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes”, e dorëzuar nga ndërmarrja NQ “Termokos” SH.A., adresa: rruga “28 Nëntori”, pndardani/Prishtinë, Republika e Kosovës.

në mbledhjen e mbajtur më 12 tetor 2012 nxori këtë:

VENDIM

- I. APROVOHET** “Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes” të NQ Termokos SH.A.

Arsyetim

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën e të licencuarit - NQ Termokos SH.A. për miratim të dokumentit: “Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes”.
2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit “Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes” të dorëzuar nga NQ Termokos dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE -së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II.** I licencuari obligohet që pas pranimit të këtij vendimi menjëherë të publikojë “Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes” në faqen elektronike zyrtare të tij.
- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi palët e pakënaqura mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i Vendimit ose nga data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Shtojcë: " Standardet e Planifikimit dhe të Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes" të NQ Termokos.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, Kryesues

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar

Merita Kostari, Anëtare

Krenar Bujupi, Anëtar